



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal of Kacanik

01Nr. 60/01-2201/22  
Kaçanik, 28.01.2022

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I-rë (parë) e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 28 janar 2022. Mbledhja është mbajtur në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsyé për shkak të infektimit me Covid-19, anëtari Rrustem Zenuni.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Nënkyetari i Komunës, Sabedin Vishi, Drejtoret e drejtive: Qamil Stagova, Dardana Tafili-Dauti, Pranvera Loku-Zharku, Hafize Sallahi, Sali Malsiu, Suhad Dulovi, Bahri Selimi, Ramadush Osmani, dhe Zahir Doda, ndërkaq nga zyrtarët e komunës të ngarkuar me detyra zyrtare ishin: Festim Neziraj, Fatlume Guri-Selimi, Arbnora Kuka, pati zyrtarë tjerë nga kabineti i zyrës së kryetarit.

Nga OSBE- mbledhjen e monitoroj Faruk Dërmaku.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Telprezencës nga Vjosa Ahmetaj- Zyrtare e lartë për monitorim të komunave në MAPL.

Mbledhjen e kryesoit Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtëse Makfire Malsiu.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Mërseli:** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndes të gjithëve iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, kushte pune për t'u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e I-rë (parë) të rregullt të kuvendit të komunës për vitin 2022, data 28 janar 2022, me këtë:

## REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 29.12.2021;
2. Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022;
3. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022;
4. Raporti i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2021;
5. Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB;
6. Informatë e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e periudhës të parë të Vitit shkollor, 2021/2022;

7. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar në vitin 2021, shkollave të komunës;
8. Kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës - AKK, për emërimin e delegatëve në Kuvendin e AKK;
9. Kërkesa e Artan Mezraja, për dorëheqje nga Komiteti Konsultativ për Persona me aftësi të Kufizuara;
10. Kërkesa e Argjenta Axhami, për dorëheqje nga Komiteti Konsultativ për Persona me aftësi të Kufizuara.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Dy pikët e fundit, kërkesat për dorëheqje na kanë ardhur vonë, ndërkaj me pajtimin e juaj kërkoj të hynë në rend punë edhe pikat 9 dhe 10, pasi që duhet të filloj procedura për zgjedhjen e anëtarëve të rijnë. Rendin e punës me shtimin e 2 pikave e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 1 votë kundër, atë të Betim Shala. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### **APROVON**

**Rendin e punës në përbërje prej 10 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 29.12.2021;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së kuvendi i komunës e,

#### **APROVON**

**Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës e datës 29.12.2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-38196/21.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Para se të kalojmë në pozicionin, Pyetje dhe Kërkesa, fjalën e ka Kryetari i Komunës për të prezantuar kabinetin e ekzekutivit për këtë mandat.

**Kryetari i Komunës, Besim Ilazi:** Faleminderit kryesues, përrshëndetje për të gjithë. Sa për informacion, tani e kemi kompletuar ekzekutivin e komunës dhe po e prezantoj para jush ekzekutivin e komunës;

Nënkryetar i Komunës është Sabedin Vishi.

Për Drejtorë të Drejtorive të Komunës janë emëruar:

1. Drejtoria e Administratës se Përgjithshme- Dardana Tafili –Dauti.
2. Drejtoria e Arsimit- Zahir Doda
3. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave- Bahri Selimi
4. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale- Sali Malsiu
5. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës- Ramadush Osmani
6. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit- Hafize Sallahu
7. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit- Qamil Stgova
8. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit- Pranvera Zharku
9. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë- Suhad Dullovi.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Faleminderit kryetar, atëherë kalojmë në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave. Nëse ka kush ndonjë pyetje apo kërkesë lë të urdhëroj:

### Pyetje dhe Kërkesa

**znj. Ardita Rrahmani:** Faleminderit, i nderuar kryetar i komunës, kryesues i kuvendit, të nderuar anëtar të ekzekutivit, iu uroj për marrjen e përgjegjësive të juaja dhe uroj që të punoni çdo ditë në të mirën e qytetarëve të komunës.

Pjetja për të cilën e mora fjalën; Ka kohë që gjysma e shëtitores “Ismail Raka”, është pa ndriçim publik. Ky është një shqetësim për secilin qytetar, pavarësisht moshës, për arsyen se ndriçimi publik është i nevojshëm e sidomos në këtë kohë të dimrit të reshjeve të bores, me çka po krijohen vështirësi në qarkullim për shkak të akullit të krijuar. Kërkoj nga drejtori i DSHPE z. Ramadush Osmani të merr veprime të nevojshme për çështjen e rregullimit të ndriçimit publik në atë pjesë dhe pastrimin e trotuarit nga akulli në shëtitore, në mënyrë që të lehtësohet qarkullimi i qytetarëve për gjatë shëtitores.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka:** Përvendetje për të gjithë, kam një pyetje për drejtorin e kulturës: A jeni në dijeni për problemet që po përballet KF “Lepenci” dhe a do të merrni ndonjë veprim të nevojshëm në këtë drejtim ?

**z. Agim Mani:** Faleminderit, iu përvendetje për të gjithëve, fillimi i kisha një shqetësim për punëtorët teknik të cilët janë në mirëmbajtje të kësaj seance të cilët i bëjnë rregullimin e tavolinave, sepse u detyrova ta shtyj tavolinën për t’krijuar hapësirë. Kërkoj që për herën tjetër të kenë kujdes këtë çështje. Kisha një pyetje për DSHPE sa i përket menaxhimit të rrugëve. A janë të kontraktuara të gjitha rrugët e lagjeve të cilat janë me asfalt apo vetëm rrugët e fshatrave, sepse rrugët e lagjeve nuk mirëmbahen fare nga kompania? A ka komision të formuar për të shikuar menaxhimin e mirëmbajtjes së rrugëve ?

**z. Naim Beça:** Faleminderit, së pari iu përvendetje juve, e kam një kërkesë dhe një pyetje: Diku në muajin shtator të vitit 2021 kanë filluar punimet në rregullimin e përroskës së f. Runjevë, ndërkaq punimet janë ndërprerë pas zgjedhjeve. Me datën 30.09.2021 është mbajtur një mbledhje e banorëve të f. Runjevë, dhe janë dakorduar që punimet të cilat kanë filluar për rregullimin e shtratit të përroit të përmirësohen, për shkak së nuk janë të kënaqur me ngushtimin e shtratit të lumit. Unë tani ua dërgoj të gjithëve në email dhe mund a shihni me foto, se askund në botë nuk mund të ndodhë që një lumë, një përroskë me u ngushtuar dhe punimet të shkojnë në këtë lloj forme d.m.th. një pjesë e përroskës është e shkatërruar plotësisht dhe e kanë lënë ashtu. Në anën tjetër, duke dashur të mbulojnë këto shkatërrimet që i kanë bërë, kanë filluar të vendosin gurë anash dhe e kanë ngushtuar shumë përroskën. Ngushtimi i përroit sjellë vërvshime, vërvshimet shkaktojnë dëme në komunitet. Nëse komuna jonë donë më i shkaktuar dëme komunitetit, atëherë është tjetër temë. Punimet janë ndërprerë pas zgjedhjeve, punëtorët të cilët i kanë pyetur ata të komunitetit Runjevë, pse janë ndërprerë punimet, përgjigja ka qenë së kështu iu ndodhë nëse nuk e votoni PDK. Kjo po me kujton kohën e komunizmit, d.m.th. ndarja e qytetarëve në baza partiake, ndarja e lokaliteteve në baza partiake, kjo është e pa pranueshme. Prandaj po e parashtroj pyetjen: përsë janë ndërprerë këto punime? Kërkesa është: të pjesa rreth shkollës filllore në Kaçanik, duhet vendoset një rampë. Qarkullimi i njerëzve të ETC është shumë i madh, në rast së kalojnë fëmijët aty. Për momentin nuk ka qarkullim të trenit, ajo pjesë paraqet rrezik permanent dhe aty mundet të ndodh një

tragjedi shumë e madhe. Andaj ju lutemi të merrni masa për vendosjen e një laure në atë pjesë sa nuk ka ndodhur ndonjë fatkeqësi.

**z. Agim Çaka:** Përshendetje për të gjithë, përshendetje për drejtoret e ri që kanë marrë detyrën. Unë kam me ngritur një çështje për kompleksin e qytetit të vjetër, ndërkaq nuk kam kurrfarë informacioni së cili është projekti, kush është kryesi i punimeve, sa ka kushtuar projekti dhe kush e financon ? A ekziston plan përfundimtar sesi do të duket ky projekt dhe a do të ketë ky kompleks elemente të qarshisë së vjetër ? Lidhur me këtë projekt, kërkoj me na ofruar një raport me shkrim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për pyetje dhe kërkesa kur ngjiten, drejtoret e drejtive marrin shënimë dhe në mbledhjen vijuese të KK i jepin përgjigjet me shkrim, për shkak së mund të ngiten pyetje për të cilat drejtori mund të mos i ketë të gjitha informacionet. Atëherë, kalojmë në pikët vijuese:

2. Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në mbledhjen e kaluar të KK u formua një komision për hartimin e planit të punës së KK. Komisioni e ka hartuar një plan pune, unë nuk kam pasur mundësi me marrë pjesë në atë takim. Plani është në vija të trasha, paraqet objektivat kryesore dhe i njëjtë mund të plotësohet sipas kërkesave dhe nevojave të cilat paraqitet, qoftë nga ekzekutivi apo nga qytetarët. Është një pasqyrë e përgjithshme e punës së KK për vitin 2022, por nuk do të thotë së është 100 %, sepse mund të shtohet apo hiqet ndonjë pikë. Në këtë plan pune janë të parapara mbledhjet e rregullta të KK. minimumi i mbledhjeve obliguese me pagesë për një vit është 10 mbledhje, ndërkaq maksimumi i mbledhjeve me pagesë është 12 mbledhje. Pesë apo gjashtë mbledhje do të mbahen në gjashtëmujorin e parë, ndërkaq pesë apo gjashtë mbledhje në gjashtëmujorin e dytë. Në muajin korrik do të mbahen dy mbledhje, muaji gusht është muaji i pushimit. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Ky plan pune i vitit 2022 është i harmonizuar mirë, i bazuar në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe në Rregulloren e punës së KK dhe si i tillë duhet gjetur zbatim. Në emër të LVV konfirmoj së e mbështetim këtë plan pune.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë plan pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për aprovimin e Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-1567/22.**

3. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ky Plan i punës nuk votohet, por ekzekutivi i komunës e sjell në KK për të debatuar. Është një plan i punës të cilin ekzekutivi e harton për aktivitetin e vet, në të cilin plan përcaktohen objektivat dhe qëllimet që do t'i realizojnë për gjatë vitit. Prezent në mbledhje është kryetari dhe drejtoret e drejtive. Për këtë pikë e hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Faleminderit kryesues, fillimisht iu uroj të gjithëve marrjen e detyrave të reja. Sa i përket planit të punës së ekzekutivit të komunës desha me u ndërlidhur të struktura gjinore, ku nga 9 drejtori, vetëm 3 drejtori drejtohen nga femrat. Këtu përfaqësimi gjinor është tejet i mangët, ndërkaq do të ishte i plotë vetëm kur do të ishte në përqindje 50 me 50. Të Zyra për barazi gjinore, ka pabarazi gjinore në atë zyrë, sepse nga 2 zyrtarë të punësuar në atë zyrë, të dy janë të gjinisë mashkulllore. Kërkesa ime është; të shqyrtohet mundësia e ndonjë kodit buxhetor, të punësohet së paku 1 asistente, ku do të ndihmonte në arritjen e objektivave të zyrës për barazi gjinore, pasi që pa përfaqësim të dy gjinive në atë zyrë, nuk mund të flasim për barazi gjinore.

Kur jemi të implementimi i projekteve të drejtive përkatëse, projekt i për ndërtimin e kanalit të ujitjes në f. Doganaj- Soponicë- Nikaj, fshati Kovaçec nuk përmendet fare. Projekt i kanalit të ujitjes ka filluar më parë në f. Kovaçec, ndërkaq ka mbetur në gjysmë dhe nuk dihet kur përfundon. Nëse mund të na tregoni; A është në prioritet për sivjet kanali i ujitjes në f. Kovaçec, i cili ka mbetur në gjysmë, nëse jo, atëherë kur përfundon ky projekt ?

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi:** Faleminderit, Plani i punës është mjaft voluminoz, jemi munduar me pëershruar pikat ashtu siç i kemi paraparë për këtë vit. Plani mund të duket se është i njëjtë me vitet tjera, por shumë aktivitete janë të rregullta. Sa i përket zyrës për barazi gjinore, zyra nuk përcakton gjininë, punësimi në komunë bëhet sipas kritereve e jo sipas dëshirës së kryetarit dhe me largu ndonjë zyrtar nga puna, ka procedura tjera që nuk ka të drejtë as kryetari as kushdo qoftë. Sa i përket çështjes së ekzekutivit, është e drejtë e kryetarit me vendosur. Mesazhin tim të cilin e kam dhënë në zgjedhje e kam zbatuar. Unë kam thënë që do të janë 3 femra drejtore, se ka qenë mandatin e kaluar vetëm 1 dhe e kam zbatuar premtimin e dhënë. Do të ishte mirë edhe me tepër femra dhe dita ditës femra po vjen duke u avancuar. Nga 93 femra të rekrutuara në mandatin e kaluar, 82 janë të gjinisë femërore dhe 11 meshkuj, shpresojmë edhe në ekzekutiv të jetë numri më i madh në të ardhmen.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, plani ishte sa për njoftim. Në bazë të kësaj mund të konstatojmë së Kuvendi i Komunës, u,

#### Njoftua

**Me Planin e punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022 / Lënda: 01Nr. 104/02-1875/22.**

**4. Raporti i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2021;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ky komitet merret kryesisht me personat me aftësi të kufizuara. Është i formuar nga KK dhe i raporton kuvendit. Raporti prezanton punën e këtij komiteti për vitin 2021. Ky komitet fillimisht ka filluar me funksionu mirë, të gjitha raportet kanë qenë të mira, edhe ky raport është i mirë, mirëpo për shkak të pandemisë kanë pasur ngecje në aktivitet. Po të ishte kryesuesi i këtij komiteti këtu, do të ishte më mirë, sidoqoftë e hapi diskutimin në këtë pikë:

**z. Agim Mani:** Faleminderit kryesues, është shqetësuese që ky komitet nuk ka realizuar qëllimet për të cilat është formuar. Duke marrë për bazë kategoritë për të cilat është formuar ky komitet, nevojat e tyre, ky komitet gjatë vitit 2021 ka mbajtur vetëm një mbledhje, ndërkaq me Udhëzim Administrativ të MAPL është i përcaktuara numri i mbledhjeve të këtij komiteti, 6 mbledhje për 1 vit, ndërkaq arsyetimi i tyre është së ka

ndikuar pandemia dhe viti zgjedhor që nuk ka mbajtur me tepër mbledhje. Është mirë që për hera tjera ky komitet të ketë një mbikëqyrje më të madhe institucionale për realizimin e aktiviteteve të tyre, sepse arsyetimi i dhënë në raport për mos mbajtje të mbledhjeve të përcaktuar nuk mund të merret për bazë.

**znj. Ardit Rrahmani:** Faleminderit, fillimi shqiptar mos prezenca e kryesuesit të këtij komiteti lënë për të dëshiruar, e sidomos pas mbledhjes që e kemi mbajtur 3 apo 4 ditë më herët. Ne, edhe pse nuk kemi qenë pjesë e legislaturës së kaluar, e kemi përcjellë këtë komitet me herët ka qenë mjaft aktiv. Lënë për të dëshiruar edhe çështja e pjesëmarrjes së ekzekutivit të komunës, me përjashtim të DAK në këtë komitet. Rekomandimet që i ka dhënë ky komitet nuk kanë gjetur zbatim nga ekzekutivi. Besoj se me formimin e komitetit të ri konsultativ, rekomandimet të cilat epën nga ky komitet të gjejnë zbatim, për shkak së është një kategori mjaft e ndjeshme e shoqërisë tonë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Raporti e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë ishin 2 anëtarë, Betim Shala dhe Ardit Rrahmani, Abstenuan anëtarët nga LVV me përjashtim të Naim Beça i cili votoj Për. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Me të cilin e aprovoj, Raportin e punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuar, për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-1864/22.**

5. Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sipas Udhëzimit Administrativ, formimi i këtij këshilli është obligues pas çdo legjislaturë. Kryetari i ka emrat dhe do t'i prezantoj të njëjtë. Fjalën e ka Kryetari i Komunës, Besim Ilazi:

**Kryetari i Komunës:** Faleminderit, KKSB është organ konsultativ, këshillëdhënës me tepër. Formohet në çdo legjislaturë, mandatin e ka 4 vjeçar. Emrat përcaktohen në bazë të pozicioneve dhe organizatave nga vijnë. Ky komitet i ka obliguese me i mbajt 6 mbledhje për 1 vit. Përbërje e KKSB është si vijon: Kryetari i Komunës- Kryesues, Besim Ilazi, Komandanti i Stacionit Policor në Kaçanik, Halim Shehu, Përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik, Fidaim Fazliu, Kryesuesi i Komitetit për Komunitetet, Ekrem Livoreka, Zyrtari për Barazi Gjinore, Vedat Dema, Drejtori i Drejtorisë për Arsim, Zahir Doda, Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit, Jashar Selimi, Përfaqësuesi i FSK-së, Përfaqësuesi i Këshillit Lokal për Siguri Publike, Shemsedin Abazi, Kryesuesi i Ekipit Veprues Komunal për Siguri në Bashkësi, Fatmir Çaka, Përfaqësuesi nga Sektori i Emergjencave Civile dhe Komunale, Bujar Bajra, Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Fadil Guri, Përfaqësuesi i OJQ-ve Lokale, Naim Hysa, Përfaqësuesi i Bizneseve, Ylber Tusha, Përfaqësuesi nga Komuniteti lokal i personave me aftësi të kufizuar, Elmihane Krasniqi.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Faleminderit kryetar, KKSB për momentin janë këta emra që i potencojoj kryetari, ndërkaq sipas pozicioneve mund të ndryshojnë. E hapi diskutimin për këtë pikë:

**z. Agim Mani:** Përbërja e KKSB është prej 17 anëtarëve, ndërkaq nuk u përmend përfaqësuesi i mediave lokale. Edhe të komuniteti pakicë nuk pati përfaqësues. Nuk jemi

kundër themelimit të këtij këshilli, por jemi kundër procedurave, për faktin së emrat që u prezantuan tani, është dashur të na vijnë me material.

**zpj. Ardit Rrahmani**, Në bazë të cilave kritere zgjidhet përfaqësuesi i OJQ lokale në këtë këshill ?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Përfaqësuesit bëhen në bazë të pozitave, p.sh. komandanti i policisë vjen në bazë të pozitës. OJQ besoj së mblidhen dhe përcaktojnë një emër. Neve zakonisht na i sjellin me email emrin e propozuar. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimin për formimin e KKSBB e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 12 anëtarë (LDK dhe LVV), Abstenim nuk ka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori,

#### VENDIM

Për themelin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në përbërje si vijon:

1. Kryetari i Komunës- kryesues, Besim Ilazi
2. Komandanti i Stacionit Policor në Kaçanik, Halim Shehu
3. Përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik, Fidaim Fazliu
4. Kryesuesi i Komitetit për Komunitetet, Ekrem Livoreka
5. Zyrtari për Barazi Gjinore, Vedat Dema
6. Drejtori i Drejtorisë për Arsim, Zahir Doda
7. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit, Jashar Selimi
8. Përfaqësuesi i FSK-së,
9. Përfaqësuesi i Këshillit Lokal për Siguri Publike, Shemsedin Abazi
10. Kryesuesi i Ekipit Vepruar Komunal për Siguri në Bashkësi, Fatmir Çaka
11. Përfaqësuesi nga Sektori i Emergjencave Civile dhe Komunale, Bujar Bajra
12. Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Fadil Guri
13. Përfaqësuesi i OJQ-ve Lokale, Naim Hysa
14. Përfaqësuesi i Bizneseve, Ylber Tusha
15. Përfaqësuesi nga Komuniteti lokal i personave me aftësi të kufizuar, Elmihane Krasniqi. / Lënda: 01Nr. 104/02-1854/22.

6. Informatë e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e periudhës të parë të vitit shkollor, 2021/2022;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kjo është një informatë që e bien drejtoria e arsimit pas përfundimit të pjesës së parë të vitit shkollor. Drejtorin e arsimit e kemi nga legislatura e kaluar, nëse keni pyetje mund t'iu përgjigjet. E hapi diskutimin:

**zpj. Arlinda Rakoci-Raka:** Ajo çka me shqetëson nga të dhënat në informatë, është rënia e numrit të nxënësve, ku në shkollat e mëdha, rënia e numrit të nxënësve ishte mbi 100 nxënës. Shqetësuese është edhe numri i madh i mungesave. Cilat janë arsyet që po ndodhin këto, sepse 14.474 mungesa janë në SHM “Skënderbeu”, 12.467 mungesa të SHMP, d. th. m. 23.6 mesatarja në përqindje po i bien të SHM “Skënderbeu”, ndërkaq 34.4 të SHMP, që d.m.th një numër mjaft i madh ?

**z. Adnan Reka:** Informata e DA është dokument i shkruar mirë me informata të mjaftueshme, por, jo të drejta për mua. P.sh. po t'i shohim investimet në infrastrukturën shkollore prej 120,000 euro, gati vetëm shkollën e Kovaçecit nuk mund ta gjeni në mesin e shkollave përfituese të komunës, ndoshta sepse ju ende e konsideroni ‘Shkollë moderne dhe bashkëkohore’ me investime të tepërta, por në fakt shuma e kësaj shkolle me dy kontrata zyrtare është vetëm 381.130 euro. E në anën tjeter me kontrata të kamufluara keni shpërblyer Operatorë Ekonomik me dosje kriminale të cilët ndoshta ende janë në arrest shtëpiak për shkak të keqpërdorimeve ekonomike. Ndonëse shkolla e Kovaçecit është një shkollë re e cila vitin e kaluar filloi punën, muret e kësaj shkolle kanë lagështi në të gjitha anët nga poshtë, ndërsa nga lartë çatia e shkollës rrjedh në mënyrë të tmerrshme edhe nëpër klasë ku zhvillohet mësimi. Nxehja e shkollës funksion minimalisht, duhen stufa elektrike shtesë për t'i ngrohur klasat, dhe nuk po flas për kualitetin tepër të dobët të inventarit shkollor, por po flas edhe për disa paradokse të qeverisjes tuaj, kur shkolla ka nevojë për banka, shkollës i vijnë dollapë, kur shkolla ka nevojë për tonerë shkollës i vijnë letra, e në disa shkolla gjenden me dhjetëra tonerë të rezervuar varësisht nga lidhjet politike që kanë drejtoret. Ju ndoshta pretendoni se po ndërtoni shkolla të kompjuterizuara, por unë konsideroj se ju më shumë po krijoni shkolla depo, ku mund të fshihni vjetërsirat apo porositë e keq-menaxhuara të pajisjeve shkollore. Cilësia në arsim nuk mund të jetë e mirë nën tingujt e pikave të shiut të kovës me ujë në klasë, apo rrezikut nga shembja e tavanit ose kontaktit të rrymës me ujë. Si rezultat i një cilësie të tillë në arsim, në shkollën e mesme profesionale nga 399 nxënës vetëm 147 e kalojnë këtë gjysmë vjetor, do të thotë as gjysma dhe nota mesatare është vetëm 2.48 d.m.th. mjaftueshëm. Si rrjedhojë kemi edhe rënie të numrit të nxënësve nga viti në vit, cili prind do t'i dërgonte fëmijët e tij në këto shkolla po të kishte alternativë, ku me shume do te shpenzonë për shërimin e fëmijëve se sa për shërimin e tyre. Në nivelin e I dhe të II këtë vit kemi 128 nxënës më pak, ndërsa në dy shkollat e mesme të larta kemi 136 nxënës më pak, por për çudi jo edhe numri i mësimdhënësve ka rënë, përkundrazi numri i mësimdhënësve është rritur, këtë vit kemi 5 mësimdhënës më tepër në këtë nivel dhe atë veçmas nga 20 mësimdhënës praktikant të angazhuar gjatë pandemisë.

**z. Zahir Doda- Drejtori i Drejtorisë së Arsimit:** Unë nuk e kam ndërmend me dialogu, megjithatë vetëm si informatë me përcjellë. Edhe shkolla e Glloboçicës ka pikur dhe ka qenë drejtori i shkollës i cili i e ka gjetur dike dhe e ka rregulluar ato defekte. Në tre vende ka pikuar ajo shkollë për dijeninë tuaj z. Adnan. Të dhënat sa ka kushtuar nuk i kam për shkollën e Glloboçicës, se nuk m'i kanë dërguar ministria, por me të njëjtin nivel iu ka ndërprerë kontrata dhe operatori i dytë e ka përfunduar projektin, për dijeninë tuaj, po të garantoj së këtë e di sigurt, e di edhe menaxherin e ministrisë dhe mundem me kontaktuar me të ministrisë dhe me t'i sjellë çmimet të gjitha. Për çështjen e bankave dhe tavolinave, unë nuk kam ndonjë kërkesë së mungon ndonjë karrikë apo tavolinë në shkollën e Kovaçecit, nuk e di pse po thua së mungojnë, ormanët iu kanë ardhur pas karrikave, ju thoni së vend të karrikave na janë sjellë ormanë.

**z. Adnan Reka:** Nëse me keni kuptuar, unë thashë, kur ne kërkojmë banka na vijnë ormanë, kur ne kërkojmë karrika, na vijnë letra. Kur ne kërkojmë toner, na vjen diçka tjetër.

**z. Zahir Doda,** Nuk është e vërtetë kjo që po thoni z. Adnan. Janë të pavërteta ato që i thoni ju, 90% janë të pavërteta. Shkolla pikë, është e vërtetë së pikë, por është larguar lagështia.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk e kam ndërmend të zhvillohen biseda në bashkëbisedim z. Adnan. E merr fjalën e tha atë që e ke ndërmend me thënë, sepse duhet t'i përbahemi rregullores. Kërkoj për rend dhe rregull në seancë. Secili që debaton për atë që e merr fjalën në kuadër të pikës, kam me dëgjuar, por jo në vazhdimësi pyetje përgjigje në kuadër të pikës që me shndërruar debatin në bashkëbisedim, sepse kjo nuk është formë e debatit. Çka keni pyetje, mundeni me shkuar të drejtoria me ua dhënë.

**z. Adnan Reka:** Unë kërkova leje se a mundem me u përgjigjur. Ju më dhatë mundësinë me u përgjigjur, ndërkaq ekzekutivi po me bëjnë vazhdimisht pyetje të shkurta shtesë dhe nëse me bëni pyetje, a duhet unë me u përgjigjur ?

**z. Agim Mani:** Debat i kontribuon çdo çështje. Po mos të debatonte Adnani së shkolla pikë, drejtori nuk e pranonte. Për çdo debat, sa me shumë që debatohet për çështje, është zgjidhje me i mirë, debati i kontribuon zgjidhjes më të mirë të çështjes. Duhet të debatohet derisa sa të kuptohet në detaje problemi apo deri sa të vjen të zgjidhja e problemit.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Në rregull është, secili ka me debatuar kur e merr fjalën në minutat e caktuar, por jo në vazhdimësi me i bërë pyetje njëri tjetrit e me zhvilluar mbledhjen në bashkëbisedim. Kushdo e merr fjalën, ka me diskutuar dhe unë kam me dëgjuar, por jo me zhvilluar debatin në bashkëbisedim, sepse kjo formë është jashtë rregullores.

**z. Naim Beça:** Në bazë të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 32 / ligji Nr. 05/88, çdo shkollë është e obliguar me i pasur njësi shkollore të trafikut të sigurisë në trafik. Në nenin 3 pika 6 thuhet: Në hapësirat e shkollave dhe në afërsi të tyre, sigurimin e fëmijëve gjatë kalimit nëpër rrugë dhe në vendkalimin e këmbësorëve mund ta kryejnë edhe përfaqësuesit e njësive shkollore të trafikut. Sipas nevojës, kërcohët asistëncë e Policisë. Pyetja është: a kemi njësi shkollore të trafikut ? Unë nuk kam parë që dikush bëhet drejtor i shkollave dhe i merr këto veprime me bërë kërkesë me i siguruar nxënësit në shkolla. Pika 4 e nenit 3 thotë: Gjatë kohës së kryerjes së detyrave nga ky nen, pjesëtarët e njësive shkollore të trafikut duhet të mbajnë rroba sipas dispozitave përkatëse. Programi, mënyra e aftësimit dhe veprimet e njësive shkollore të trafikut, rrobat dhe emblemat përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Punëve të Brendshme. Pyetja është: a kemi njësi shkollore të trafikut ?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Jemi duke folur për informatë përfundimin e pjesës së parë të vitit shkollor, nëse ka diçka rrëth informatës, na epën përgjigjet nga drejtori. A ke drejtor

diçka për pyetjen për njësinë e trafikut ? Përgjigjen e jep pasi të përfundon diskutimin z. Adnani nëse ka me shtuar diçka.

**z. Adnan Reka,** Po mundohem me qenë i kujdeshëm kryesues. Atëherë edhe ekzekutivi i komunës të kryejnë fjalën e vet, e mos t ‘na bëjnë pyetje të shkurta shtesë gjatë diskutimit, se janë edhe minutat shtesë për replikë nëse ka nevojë. Dy herë më janë bërë pyetje shtesë gjatë diskutimit e unë u detyrova me u përgjigjur.

**z. Zahir Doda:** Jo, për njësinë e trafikut, pyetja është jashtë informatë, përgjigjen mundem me ua dhënë me shkrim, kurse pjesa e pyetjeve që lidhen me informatën, nota mesatare të SHMP, kjo gjendje është pothuajse në krejt shkollat profesionale të Kosovës, duke përashtuar shkollën e mjekësisë. Më mirë është me reflektuar një realitet, unë me tepër kam pritur pyetje me thënë qysh ka mundësi drejtor që nota mesatare me qenë mbi 4 krejt shkollat, kjo me është tragjike sesa nota mesatare që është 2.48 në SHMP. Përgjithësisht po e mbyllë fjalë time edhe me një vërejtje, prej dialogut nuk u binda, por e di që shkolla e Kovaçecit pikë dhe kemi tentuar disa herë me sanuar, se nuk është bërë me iu zënë besë fotografive se nuk mund të jenë ndonjë argument.

**z. Agim Çaka:** Sipas mendimit tim, raporti është i përpiluar mirë, me të gjitha elementet që duhet me i pasur një raport. Mua me interesojnë investimet që janë bërë në shkolla dhe suksesi i shkollave. Të investimet e pashë se janë paraqitur në total, si; ngjyrosja e mureve dhe vendosja e dyerve nëpër shkolla, ndërkaq nuk kemi të dhënët të specifikuara sesa ka kushtuar ngjyrosja e shkollave dhe sa kanë kushtuar dyert e vendosura në shkolla. Investime në shkolla mendoj se duhet me u specifikuar, sepse nuk mundemi me ditur çfarë ngjyrosje është bërë dhe çfarë dyersh janë vendosur. Sa i përket suksesit, të SHMP nuk jam i kënaqur me suksesin me këtë notë mesatare. Sipas mendimit tim, një shkollë që ka notë mesatare 2.4 drejtorin e asaj shkolle duhet me dërguar në shtëpi.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kjo është informatë që i përmban të dhënët përfundimin e pjesës së parë të vitit shkollor, çështja e financave paraqitët në raportin finansiar që e harton ekzekutivi i komunës në çdo 3 muaj dhe vjetor.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Për mua është shqetësuese që shkolla e Kovaçecit pikë. Unë vijë nga ai vend dhe për mua si asambleiste kjo është shqetësuese. Nëse ne ndërtojmë shkollë të re dhe pikë kulmi apo ka lagështi, atëherë për fëmijët është shumë shqetësuese kjo. Nuk mundemi me i thënë fëmijës ruaje shkollën, kur ata thonë që shkolla pikë, aty duhet me u gjetur shkaktari. E dyta, shkolla që u ndërtua në Kovaçë, nuk ka sallë të edukatës fizike. Mua nuk me duket ky projekt i përfunduar përderisa është i mangët pa sallë të edukatës fizike, për të kryer nxënësit aktivitete sportive të orës mësimore.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës u,

**Njoftu**

**Me informatën e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e periudhës të parë të vitit shkollor, 2021/2022 / Lënda: 01Nr. 04-610-1727/22.**

7. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar në vitin 2021, shkollave të komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Një vendim i kësaj natyre është marrë që sa vite me radhë. Kemi pasur probleme me agjencinë pyjore, meqë ata e kërkojnë pjesën e tyre. Megjithatë ne si KK kemi vendosur që këto dru të konfiskuara me ua shpërndarë shkollave me vendim të KK, me arsyetim e drejtorisë së e kursejmë buxhetin në shkolla. E hapi diskutimin në këtë pikë:

**z. Agim Mani:** Për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, ne i kemi mendimet tona. Kjo është pasuri e komunës dhe ligjërisht procedura duhet të shkoj përmes ankandit publik, siç është vepruar në herën e kaluar me masën e druve teknik –dru, të veprohet njëjtë, sepse në formën e propozuar me i ndarë, mendojmë po bëjmë shkelje. Janë të konfiskuara sasi 161.56m<sup>3</sup> metër kub dru, ndërkaq të shprehura në hapësirë është 231 mh - metër hapësirë. Nëse mund të me shpjegoni çka është sasia metër hapësirë, së nuk e kam të qartë, duke ditur së drutë maten me m<sup>3</sup> e jo me mh. Tjetër, qysh është marrëveshja me SHIL me ndarjen e masës drusore 50% me 50%.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi :** Faleminderit, edhe kryesuesi e përmendi së është një lloj shkelje, dhe këtë nuk e kemi mohuar asnijëherë, duke marrë parasysh së nëse i shkojmë përmes ankandit publik dhe i shesim drutë me një vlerë të vogël, ndërkaq i blenë me një vlerë shumë më të madhe, e kemi menduar se po e kursejmë buxhetin e komunës. Nëse ju e vlerësoni këtë formë, ne nuk na praqet asgjë edhe me procedurë të ankandit, por çështja është së 70% i shkojnë agjencisë, ndërkaq 30% i mbresin komunës. Sa i përket m<sup>3</sup> dhe mh, metri hapësirë më e madhe që e shprehim në jetën e përditshme. Nuk jam matematikan, por kështu e di. Nëse ka diçka që është jo e qartë, e verifikon komisioni.

**z. Kadri Krivenjeva:** Drejtori është prezent këtu dhe mund të na shpjegoj metër kub dhe metër hapësirë.

**z. Adnan Reka:** Sa e kuptova unë, këtu po bëhet fjalë për një shkelje, d.m.th. po e shkelim ligjin me vetëdije. Nëse ne po e dimë se po e shkelim ligjin me vetëdije, atëherë ju shkelni, por ne nuk do të bëhem i pjesë e kësaj shkelje me vetëdije, ndërkaq nëse e shkelim ligjin pa vetëdije, është tjetër çështje.

**Kryetari i Komunës:** Sa i përket asaj që thash së e shkelim ligjin, z. Adnan, unë i përmenda arsyet e mia. Ne, ka sa vite që e kemi miratuar një vendim të tillë dhe MAPL asnijëherë nuk na e ka kthyer në rishqyrtim si të kundërligjshëm. Sipas ligjit për pyjet, drutë e konfiskuara duhet të shitën me ankand publik, por nga shitja 70% të mjeteve i merr agjencia, ndërkaq 30% i marrim ne. Ne kemi menduar që ato dru t'ua japim shkollave, ndërkaq mjetet e ngelur për dru që janë të planifikuara t'i shpenzojmë për ndonjë aset tjetër të shkollave, qoftë për banka, karrika apo diç tjetër. Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, me asetat e komunës menaxhon komuna. Është zyra ligjore, vendimi i shkon zyrës ligjore të MAPL, kështu që nëse ka shkelje, na e kthen vendimin në rishqyrtim. Nëse e vlerësoni së është vendim i dëmshëm, edhe unë jam me ju, por që 5 vjet që marrim një vendim të tillë, ndërkaq MAPL nuk na ka kthyer asnijëherë në rishqyrtim. Unë mendoj se po e marrim vendimin me të mirë që kemi mundësi për këtë çështje. Është një marrëveshje që ka ekzistuar me SHVL, edhe atë marrëveshje mundem

me prishur. Të gjitha komunat janë duke përdorur këtë metodë, Hani i Elezit ia ndanë komunës e jo shkollave. Në një vit me vendim të kryetarit i janë ndarë skamnorëve dhe vendimi na është kthyer nga MAPL për rishqyrtim.

**z. Agim Çaka:** Kërkoj një sqarim së a ka shkelje ligjore apo nuk ka të ndarja e masës drusore, në mënyrë që unë të marrë vendimin tim si të votoj. Nëse me vetëdije e shkelim ligjin, duke thënë se hajt së ndoshta kalon në ministri, nuk është mirë të shkoj në këtë formë. Nëse ju e pranoni së ka shkelje ligjore, atëherë unë si anëtar i KK nuk e votoj këtë çështje, jo pse nuk dua me kontribuar në çështjen e ndarjes së druve shkollave, por nuk dua të bëhem pjesë e shkeljes ligjore. Nëse ju mendoni së ka shkelje ligjore, jo vetëm kjo çështje, por edhe çështje tjera, nuk janë mirë me kaluar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është e drejtë e secilit dhe mendim i secilit me dhënë mendimin e vet. Ne këtu nuk jemi komunë aksionare me ditur se ku kemi bërë shkelje ku jo, së edhe ligji për vetëqeverisje lokale që i dominon ligjet tjera, thotë së komuna menaxhon me astet e veta. Ne nuk mundem me ditur se a është çdo vendim i ligjshëm, drejtoria mundet me ditur a është në harmoni me ligjin apo jo. Për këtë arsyen vendimet e KK i shkojnë në shqyrtim MAPL. MAPL në afat prej 15 ditësh është i obliguar të njoftoj kryetarin dhe KK me ligjshmërinë e vendimit. Nëse është i paligjshëm, na i potencon arsyen. Nëse është i ligjshëm, na e shkruan se vendimi prodhon efekte juridike. Ne mundemi me debatuar këtu se a është i ligjshëm apo i paligjshëm, por është organi shqyrtues që tregon cili vendim i KK është i ligjshëm e cili jo. Drejtori është i obliguar me shqyrtuar ligjin që e bazon aktin dhe me i proceduar për KK edhe nëse drejtoria ka gabuar, është MAPL që tregon ligjshmërinë e secilit vendim të KK. po duhet me shpjeguar para të gjithëve procedurën. Ne kemi pasur raste që MAPL na i ka kthyer vendimet dhe i kemi rishqyrtuar ose i kemi anuluar.

**z. Agim Çaka:** Në njëren anë ne po e dimë që është shkelje ligjore, ndërkaq në anën tjetër komuna e ka një zyre ligjore dhe vendimet nuk është mirë me na ardhur këtu që nuk janë në harmoni me ligjin, e pastaj vendimi me shkuar në MAPL në shqyrtim. Unë u ndërlidha me diskutimin e personave zyrtar këtu që thonë së ka shkelje të ligjit. Në këtë rast, ne po e dimë që ka shkelje ligjore dhe me vetëdije po shkelim ligjin.

**Kryetari i Komunës:** Ligji i pyjeve të Kosovës e thotë shumë qartë se, masa drusore duhet të shitet përmes ankandit publik. Në rregull jemi këtu. Por kemi edhe Ligjin për vetëqeverisje lokale që thotë: Komuna menaxhon me asetet e veta, e që në këtë rast masa drusore është aset i komunës. Agjencisë i konvenon me i marrë 70% të mjeteve nga shitja e masës drusore, përndryshe nuk ishte interesuar fare. Pra janë dy ligje që janë në disharmoni mes veti. Për atë edhe MAPL nuk na ka kthyer vendimin negativ është e pestë herë që kemi marrë një vendim të tillë. Ne po e shfrytëzojmë për nxënës, për ndryshe e qesim në ankand dhe nuk ka kurfarë problemi. Ne i japim dikujt shitjen e druve me ankand publik, ndërkaq si komunë dëmtohem i për një shumë 150 euro, dhe nuk bëhet asgjë. Janë 2 ligje në disharmoni mes veti, dhe ne po bazohemi në ligjin që potencon çështjen e aseteve të komunës, këtë e kanë shfrytëzuar edhe komunat tjera. Ne kemi menduar me ua dhënë shkollave, se janë diku 1500m<sup>3</sup> dru që na kërkohet në vit për shkolla, dhe shumën e mjeteve për dru e shfrytëzojmë për ndonjë nevojë tjetër për arsim. Kjo ka qenë arsyja.

**z. Adnan Reka:** Çdo vendim që na vjen në KK, ne e dimë që nuk mbajmë përgjegjësi penale. Nëse ne si KK marrim çdo herë vendime të paligjshme, atëherë i bien imazhi këtij

kuvendi. Ekzekutivi paraprakisht duhet me shqyrtuar ligjshmérinë e tyre, për mos me na sjellë vendime që nuk janë në harmoni me ligjin, e jo me përligj vendimin përmes KK, përndryshe ekzekutivi të merr vet vendime të paligjshëm dhe shikoni së cilat janë pasojet e atij vendimi të paligjshëm.

**z. Agim Çaka:** Meqenëse kjo çështje është aprovuar edhe në vitet tjera dhe nuk ka pasur vërejtje, vendimi është në interes të komunës, ne nuk jemi jurist dhe nuk i dimë ligjet, ndërkaq nëse kryetari i komunës jep garanci së nuk ka këtu shkelje ligjore, atëherë sqarimi ishte i mjautueshëm për me kaluar propozim vendimi.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë për një çështje për një vendim të tillë i marrë para 2 viteve, unë kam qenë në gjykatë, sepse ligjit për pyjet, agjencia pyjor me ka paditur mua në gjykatë. Sipas ligjit të pyjeve, agjencia ka të drejtë, nuk e di nëse ka ndryshuar ligji, por ne nuk jemi të obliguar si KK me i përcjellë ndryshimet e ligjeve, sepse me i përcjellë ligjet është drejtoria përkatëse. Unë kam qenë në procedura gjyqësore, në gjykatë themelore dhe në gjykatë të apelit, ndërkaq kam qenë i kompletuar me vendimin e KK, Procesverbalin e mbledhjes dhe dërgesën që ia kemi dërguar MAPL vendimet, MAPL nuk ka kthyer asgjë në vendimin. Këto kanë mjautuar në gjykatë që më shpallur të pafajshëm. Jam ankuar në gjykatë të apelit, edhe atje njëjtë. Çdo vendim i KK i ligjshëm apo i paligjshëm jam i obliguar me nënshkruar, ndërkaq e drejta e votës time është diçka tjetër, e që kujtoj së edhe kjo nuk është vepër penale. A kanë të drejtë apo jo, është në përgjegjësi të MAPL me ia dërguar ministrisë për bujqësi për shqyrtim të ligjshmërisë. Nëse ata të ministrisë nuk e shqyrtojnë ligjshmërinë fare, nuk i kthejnë përgjigje MAPL, neve na krijohet mundësia për ekzekutim të vendimit. Agjencia e pyjeve është njësi e ministrisë së bujqësisë, pastaj ka marrë veprime për me ngritur padi në gjykatë. Ne e marrim vendimin e dërgojmë në shqyrtim të ligjshmërisë dhe nëse organi shqyrtues nuk kthen përgjigje në afat prej 15 ditësh, ne e publikojmë vendimin. Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas shpalljes dhe përfundon çështja. Kjo është procedura. Për derisa ekzistonjë procedurat për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të KK ne do të veprojmë sipas tyre. Nëse vendimi me kthehet i kundërligjshëm nga autoriteti shqyrtues, unë vendimin e sjellë në KK për rishqyrtim, sepse jam i obliguar me i përfillur vendimet e organit shqyrtues. Kur ligjet janë në kundërthënie mes veti, LVL është në epërsi të ligjeve tjera.

**znj. Ardit Rrahmani:** Atëherë unë si juriste, kemi edhe kolegë tjerë jurist, në bazë të studimit, këtu kemi të bëjmë me konflikt të ligjeve. Përse unë si anëtarë e KK me marrë përgjegjësinë me votuar, kur kemi një zyrtar ligjor që mundem me kërkuar prej tij interpretim ligjor për këtë çështje. Duke pasur parasysh se edhe kryetari e tha se kemi konflikt të ligjeve, atëherë pse nuk e kërkohet një interpretim ligjor prej zyrtarit ligjor, pasi që komuna ka zyrtar ligjor. Nëse nuk kërkohen shqyrtim ligjore nga zyrtari ligjor, atëherë për çka na shërben ai zyrtar.

**Kryetari i Komunës:** Veç diçka po të pyes Arditë, kur kemi konflikt të interesit, ne a duhet të mbrojmë interesin e qytetarëve apo të agjencisë. Për atë e ka të drejtën KK nganjëherë me marrë vendime qoftë pozitë apo opozitë për interes të qytetarëve, nëse mendojmë që është interes i qytetarëve, nëse mendojmë së nuk është interes i qytetarëve, atëherë i shesim me ankand publik, për atë është KK për do sfida që nuk mundem me i sqaruar mirë. Në ligjin e VL shkruan, kryetari i komunës menaxhon me asetet e komunës. Masa drusore është aset i komunës, përndryshe APK i merr e i shet drutë vet, po na i ka lënë neve këtë çështje, por meqë është edhe një ligj tjetër LVL, unë e kam proceduar në KK me ndarë këtë përgjegjësi. Duke parë së një vendim të tillë e kemi marrë që 4 apo 5

herë, e kemi dërguar në MAPL dhe MAPL nuk na ka kthyer asnjëherë kundërligjor. Pasi ka dualizëm ligjesh, secili po e mbrojmë vetën, unë po e mbroj vetën, ju po e mbroni vetën se nuk po e dimë se cili ligj është me i fortë. Unë e kam proceduar lëndën në KK, miratohet mirë, nuk miratohet atëherë i shesim me ankand publik.

**zpj. Ardita Rrahmani:** Atëherë kryetar, për derisa mua mu drejtuan me pyetje, për mua si asambleiste. Është bazë ligji, pavarësisht interesit të qytetarëve. Nëse një e drejtë është ekskluzive e kryetarit, ndërsa po doni me ndarë përgjegjësinë me kuvendin, po kuptohet nga fjalët së këtu nuk është diçka në rregull, atëherë merreni përgjegjësinë vet si kryetar. Meqenëse komuna ka zyrtar ligjor, pse nuk e kërkoni interpretim ligjor prej zyrtarit ligjor, për çka na shërben ai zyrtar ?

**Kryetari i Komunës:** zpj. Ardita, me duket isha shumë i qartë, kemi dualizëm ligjesh në këtë çështje, për atë e kam drejtuar propozimin këtu në KK. ligji për pyjet thotë ndryshe, ndërkaq LVL thotë ndryshe. Unë po ta dija , nuk e kisha sjellë këtu propozim vendimin. MAPL është i thirrur me vlerësuar vendimin e KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** U debatua kjo çështje dhe është e drejtë e secilit së a e voton apo jo. Askush nuk është fajtor se a voton apo jo një çështje të paktën këtu në KK. Unë nuk besoj se do të krenohet askush nesër nëse ky vendim kthehet i kundërligjshëm dhe që nuk e ka votuar, sepse insistimi i ekzekutivit është të bëhet diçka e mirë. Është mendim individual i secilit sesi të votoj, apo mund të këtë ndonjë propozim konkret. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin për ndarjen e masës drusore dhe njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin, Ardita Rrahmani dhe Betim Shala. Abstenuan anëtarët nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

**Për ndarjen e masës drusore shkollave të komunës të konfiskuar në vitin 2021, / Lënda: 01Nr. 08-322/01-1562/22.**

8. Kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës - AKK, për emërimin e delegatëve në Kuvendin e AKK;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Asociacioni i Komunave të Kosovës e ka Kuvendin e AKK, i cili përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha komunave të Kosovës dhe kryetarët e komunave. Kuvendi i AKK mblidhet një herë në vit, dhe në secilën legjislaturë delegohen anëtarë nga komunat. Numri është i përcaktuar në bazë të numrit të anëtarëve të KK, ashtu që në çdo 10 anëtarë, caktohet 1 anëtar. Komuna jonë i cakton 2 anëtarë nga KK, zakonisht caktohen nga grupet politike më të mëdha. Atëherë kërkoj nga 2 subjektet politike me të mëdha të jepin nga 1 propozim:

**zpj. Fitore Vishi:** Në emër të subjektit politik të PDK, e propozoj për anëtarë në AKK, z. Selajdin Troni.

**z. Agim Mani:** Në emër të subjektit politik të LVV e propozojmë për anëtarë në AAK, z. Bashkim Luma.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Propozimet të cilat dolën i shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtat u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

Për delegimin e dy anëtarëve të kuvendit të komunës së Kaçanikut në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës:

1. Selajdin Troni anëtar i KK nga PDK; dhe
2. Bashkim Luma, anëtar i KK nga LVV. Lënda: 01Nr. 104/02-1700/22.

9. Kërkesa e Artan Mezraja, për dorëheqje nga Komiteti Konsultativ për Persona me aftësi të Kufizuara;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Dorëheqjet e dy anëtarëve i keni parë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë kërkesën për dorëheqje të Artan Mezraja e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me shumicë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 11 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Aprovimin e Dorëheqjes së Artan Mezraja nga pozita e anëtarit në Komitetin Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara / Lënda: 01Nr. 60/01-2532/22.**

10. Kërkesa e Argjenta Axhami, për dorëheqje nga Komiteti Konsultativ për Persona me aftësi të Kufizuara;


**Kryesuesi i Kuvendit:** Edhe anëtarja Arxhenta Axhami ka bërë kërkesë për dorëheqje nga ky komitet. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim kërkesën e saj dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 12 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Aprovimin e dorëheqjes Argjenta Axhami, nga Komiteti Konsultativ për Persona me aftësi të Kufizuara / Lënda: 01Nr. 60/01-2535/22.**


**Kryesuesi i Kuvendit:** Para se me përfunduar mbledhjen, iu njoftoj së ka qenë i themeluar Shtabi emergjent për parandalimin e pandemisë Covid-19 me përfaqësim edhe të tre anëtarëve nga KK. Nga PDK ka qenë Kadri Krivenjeva, nga LVV, Agim Mani, nga LDK Besnik Salihu. A jeni të pajtimit të mbeteni prapë në këtë shtab. Të tre anëtarët u pajtuan me vazhduar me qenë pjesë e shtabit emergjent parandalimin e pandemisë Covid-19.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora 12:35. Deri në fund të mbledhjes ishin të gjithë anëtarët e KK.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu  




Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);**

**Nga Mbledhja e I-r e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2022,  
mbajtur me 28 Janar 2022:**

1. Kemal Murseli .....,
2. Brahim Imishti.....,
3. Hamide Luma .....,
4. Kadri Krivenjeva .....,
5. Fitore Vishi,.....,
6. Rrustem Zenuni,.....,
7. Edon Baftiu .....,
8. Selajdin Troni .....,
9. Fatmir Bunjaku .....,
10. Bashkim Krasniqi .....,
11. Florina Lika-Vishi .....,
12. Lejla Muhamheri-Çaka.....,
13. Agim Mani .....,
14. Kadrije Lika-Troni .....,
15. Adnan Reka .....,
16. Naim Beça .....,
17. Raif Kasa .....,
18. Ernesta Krasniqi,.....,
19. Bashkim Luma .....,
20. Arta Avdiu .....,
21. Ardita Rrahmani .....,
22. Besnik Salihu .....,
23. Betim Shala,.....,
24. Arlinda Rakoci-Raka.....,
25. Rabije Sallahi.....,
26. Ekrem Livoreka.....,
27. Agim Çaka.....



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK**  
( Legjislatura 7 e Kuvendit të Komunës, të dalë nga Zgjedhjet Lokale të 17 Tetorit 2021)

Evidenca e pjesëmarrjes së anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mbledhjen e I-r të Rregullt (Legjislatura e VII e KK), mbajtur me 28 Janar 2022

1	2	3	4	5
Nr. Rend.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Përkatësia politike	Nënshkrimi
01.	Brahim Imishti	Anëtar	PDK	
02.	Hamide Luma	"	PDK	
03.	Kadri Krivenjeva	"	PDK	
04.	Fitore Vishi	"	PDK	
05.	Rrustem Zenuni	"	PDK	
06.	Edon Baftiu	"	PDK	
07.	Selajdin Troni	"	PDK	
08.	Fatmir Bunjaku	"	PDK	
09.	Bashkim Krasniqi	"	PDK	
10.	Florina Lika-Vishi	"	PDK	
11.	Lejla Muhamheri-Çaka	"	PDK	
12.	Agim Mani	"	LVV	
13.	Kadrije Lika-Troni	"	LVV	
14.	Adnan Reka	"	LVV	
15.	Naim Beça	"	LVV	
16.	Raif Kasa	"	LVV	
17.	Ernesta Krasniqi	"	LVV	
18.	Bashkim Luma	"	LVV	
19.	Arta Avdiu	"	LVV	
20.	Ardita Rrahmani	"	LDK	
21.	Besnik Salihu	"	LDK	
22.	Betim Shala	"	LDK	
23.	Arlinda Rakoci-Raka	"	LDK	
24.	Rabije Sallahi	"	AAK	
25.	Ekrem Livoreka	"	AAK	
26.	Agim Çaka	"		



Vërtetori: Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 22.02.2022

Për: Anëtarët e Kuvendit/ znj. Ardita Rrahmani  
z. Agim Mani

Lënda:

### PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjëm dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtuar para Kuvendit të Komunës, më datë 28.01.2022, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.

**z. Ardita Rrahmani:** Ka kohë që gjysma e shëtitores "Ismail Raka", është pa ndriçim publik. Ky është një shqetësim për secilin qytetar, pavarësisht moshës, për arsyen se ndriçimi publik është i nevojshëm e sidomos në këtë kohë të dimrit të reshjeve të bores, me çka po krijohen vështirësi në qarkullim për shkak të akullit të krijuar. Kërkoj nga drejtori i DSHPE z. Ramadush Osmani të merr veprime të nevojshme për çështjen e rregullimit të ndriçimit publik në atë pjesë dhe pastrimin e trotuarit nga akulli në shëtitore, në mënyrë që të lehtësohet qarkullimi i qytetarëve për gjatë shëtitores.

➤ *Drejtoria e Shërbimeve Publike ka të kontraktuar kompaninë për realizimin e kontratës "Mirëmbajtja e ndriçimit publik" për periudhën trevjeçare.*

*Defekti i paraqitur në rrjetin e ndriçimit publik në rrugën "Ismail Raka" është sanuar me datën 28.01.2022.*

**z. Agim Mani:** Kisha një pyetje për DSHPE sa i përket menaxhimit të rrugëve. A janë të kontraktuara të gjitha rrugët e lagjeve të cilat janë me asfalt apo vetëm rrugët e fshatrave, sepse rrugët e lagjeve nuk mirëmbahen fare nga kompania? A ka komision të formuar për me shikuar menaxhimin e mirëmbajtjes së rrugëve?

➤ *Kontrata për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale është lidhur për periudhën dyvjeçare 2022-2024. Pozicionet e pastrimit të rrugëve nga reshjet e borës llogariten dhe paguhën në bazë gjatësisë (km) të rrugëve të pastruara. Prioritet në pastrim të rrugëve nga reshjet e borës, fillimisht kanë rrugët kryesore të qytetit, rrugët primare të fshatrave, rrugët që shpiejnë deri tek objektet me karakter publik (shkolla, QKMF, AMF, etj.). Në rrugicat sekondare të zonës urbane dhe ato rurale intervenohet në rastet kur kemi të bëjmë me raste emergjente (raste të sëmundjeve, dializë apo emergjencë tjeter). Kujdes të veçant i kushtojmë edhe zonave të thella malore ku të reshurat janë më të theksuara.*

*Të gjitha këto intervenime kryhen me mbikëqyrjen e menaxherit komunal të kontratës.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,



Ramadush Osmani  
Drejtor i DSHPE-s



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna Kaçanik**  
Opština Kaçanik  
Municipality Kaçanik

DATË/A:	22.02.2022
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Delegatët e Kuvendit Komunal
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Suhad Dullovi, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigjeje në pyetjen e deputetës znj. Kadrije Lika Troni , lidhur me pyetjen për vazhdimin e ndërtimit të kanalit ujitjes në fshatin Kovaçec

Përmes kësaj shkrese ju informojmë lidhur me pyetjen e deputetës znj. Kadrije Lika Troni, lidhur me kërkesën për vazhdimin e investimeve në projektin e ndërtimit të kanalit të ujitjes në fshatin Biçec dhe Kovaçec. Drejtoria e BZHRP-së për ndërtimin e kanalit të ujitjes në fshatin Biçec dhe Kovaçec, ka paraparë investime në dy fazë dhe kemi realizuar projektin ashtu siç e ka paraparë. Këtë vit me planin e punës për vitin 2022 nuk kemi paraparë investime për vazhdimin e këtij projekti, ngase e kemi paraparë investime për ndërtimin e kanaleve të ujitjes në fshatin Doganaj, Soponicë dhe Nikaj . Mjete për vazhdimin e punës për ndërtimin e kanalit të ujitjes në fshatin Kovaçec, për këtë vit nuk kemi të paraparë, mbetet të shohim për vitin e ardhshëm, a ja vlen investimi, varësisht nga sipërfaqet që përfshihen në projektin për ujitje.

Me respekt !



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

Përgjigje për anëtaren e Kuvendit të komunës, znj.Arlinda Rakoci – Raka

**zpj. Arlinda Rakoci-Raka:** Përshëndetje për të gjithë, kam një pyetje për drejtorin e kulturës: A jeni në dijeni për problemet që po përballet KF “Lepenci” dhe a do të merrni ndonjë veprim të nevojshëm në këtë drejtim ?

- *Pas publikimeve të fundit që u paraqiten rreth vështërsive të KF Lepenci dhe dorëheqjeve të publikuara, ne si Drejtori zhvilluam një takim urgjent me kryesin e klubit, ku u njoftuam për së afërm me vështësit financiare momentale. Po ashtu, zhvilluam edhe dy takime të tjera ku në bashkëbisedim me trajnerët dhe futbollistët e klubit arritëm marveshje që të fillojn stërvitjet pranverore. Tani klub i është duke zhvilluar stërvitje të përditshme në stadiumin e qytetit.*

Me respekt!

Hafizë Sallau  
Drejtore e DKRS